


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Ministria e Infrastrukturës	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
	OE ankues: “RSM Company” dhe “Sallahu”		297/19 318/19
Prej:	 Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “RSM Company” – Prishtinë dhe ankesën e parashtruar nga OE “Sallahu” - Kaçanik		
Datë	28.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 10.06.2019, me nr. 297/19 të parashtruar nga OE “RSM Company” – Prishtinë dhe ankesën e datës: 17.06.2019, me nr. 318/19 të parashtruar nga OE “Sallahu” – Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:


- Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – RSM COMPANY dhe SALLAHU.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruar nga OE “RSM Company” dhe “Sallahu”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	18.06.2019	28.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 10.06.2019, OE “RSM Company” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë për LOT I në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Lika Trade” - Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”**, Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48, me numër të prokurimit: **205-19-2318-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës**.

Me datën: 17.06.2019, OE “Sallahu” - Kaçanik, ka parashtruar ankesë për LOT I dhe III në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë për Lot I OE “Kag Asphalt Company” - Prizren dhe për Lot III OE “Lika Trade” - Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”**, Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48 dhe Lot III - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P420-P660) Stacionazha 9+274.98-14+253.21, me numër të prokurimit: **205-19-2318-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës**.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET OE “RSM Company”:

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE “RSM Company” dhe “Sallahu”, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”**, me numër të prokurimit: **205-19-2318-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës**.

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Per eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit jemi njoftuar permes Njoftimit per Vendimin e AK-se, te publikuar me dt. **03.06.2019** ne e-prokurim.

Kemi bere kerkese per rishqyrtim prane AK-se me dt. **05.06.2019**.

Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim na eshte derguar permes e-prokurimit me dt: **05.06.2019**.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, dhe Dosjes se Tenderit, Pikat 9.1 & 9.2, nenpika 6 dhe 7:

Neni 1 - Qellimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontrates

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 1 - Qëllimi thote: “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.”

Kurse Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe me vendimin e saj, ka per qellim demtimin e fondeve publike ne vlere prej **144,844.10 Euro**, pasi qe kompania e shpallur fituese ne Lot III “Lika Trade” ka ofertuar me shtrenjte se RSM Company e cila ka ofruar tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet ne Lot III.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, duke vleresuar gabimisht dhe ne mos perputhje me Ligjin e Prokurimit, duke eliminuar kompanine RSM Company shpk, edhe pse kemi dorezuar oferte te pergjegjshme dhe ne perputhje me te gjitha kerkesat e Dosjes se Tenderit.

Euro, është kryer nga kompania RSM Company shpk vetem vlera prej 60 % e asaj kontrate. Por ne po ju ofrojmë si dëshmi Marreveshjen ne mes te RSM Company shpk & Eskavatori shpk, ne te cilën theksohet se Eskavatori terhiqet nga ekzekutimi I punimeve dhe se RSM Company shpk është përgjegjës 100% për ekzekutimin e punimeve, dhe poashtu situacionet e dorezuara tek Investitori, ku shihet qartë që të gjitha situacionet janë të nënshkruara dhe dorezuara vetem nga ana e RSM Company shpk.

Poashtu AK-ja nuk ka pranuar si kontratë valide kontratën me titull: Rikonstruimi I Bulevardit Fan Noli dhe Ndricimi I Unazes Korce, me vlerë: 1,330,405.80 Euro, për të cilën pretendojnë që nuk është kontratë në leminë e kërkuar (Asfaltim, Nderim, rehabilitim, rikonstruktiv të rrugëve), që nuk është fare e vertetë pasi që shumica e dermuesve të vlerës së kontratës është tek asfalti, dhe për më tepër kjo kontratë përfshin të gjitha pozicionet e ndërtimit të rrugëve, dhe jo ashtu siç pretendon AK-ja. Si provë ju ofrojmë të gjitha situacionet e punimeve për këtë projekt që të vertetohet që kjo kontratë është në leminë e kërkuar në DT.

Në Dosje të tenderit Pika 7 - lista e makinerive, pika 10 është kërkuar “Finisher për shtrirjen e asfaltit”, në kemi paraqitur marrëveshjen për makineri të noterizuar me RSM Company shpk dhe Rruga Ing shpk, dhe si dëshmi për finisherën Caterpillar AP755, kemi paraqitur Faturën e shitblerjes së makinerive, ku Finisheri është i listuar i pari në atë faturë me përshkrimin: “Caterpillar Finisher AP755-8.1m”, për më tepër në atë faturë gjendet edhe Sperkatesja për bitumen dhe emulsion që është paraqitur në listën e makinerive, kurse AK-ja na ka eliminuar me arsyen se kinse nuk kemi paraqitur dëshmi për finisherën. – **PROVE: Marrëveshja për makineri me Rruga Ing dhe Fatura e shitblerjes së makinerive (Shitesi Al Trade – Bleresi Rruga Ing.) të cilat gjenden edhe në dokumentacionin e ngarkuar në eprokurim.**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Parashtruesit e kësaj kerkese kanë bërë shpenzime të mëdha lidhur me përgatitjen e Dosjes së Tenderit, vlera e të cilave do të përcaktohet në të ardhmen, për çka pason vlerësimi me shkrim.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtejshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni7, Barazianë Trajtim/Jo-Diskriminimi;
Neni54, Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar;
Neni59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni60, Kriteret për Dhënie e Kontratës;
Neni68, Gjendja Ekonomike dhe Financiare;
Neni69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale ;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtatëni rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Dorëzimi i ofertës është i bazuar në bazë të dosjes së tenderit të datës 19.04.2019, ku nga faqe 14 deri 21 (Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit FTD), janë të dhënat e tenderit të cilat duhet plotësuar.

Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit nga Ministria e Infrastruktura ka shkelur rregullat e LPP-së dhe ka dalë në kundërshtim me fletën e të dhënave të tenderit dhe kriteret e paraqitura në të.

Duke e pasur parasysh se kriteret e kërkuesit në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit FTD nuk janë marrë për bazë gjatë procesit të vlerësimit, me ç'rastë janë shpallur të suksesshëm operatorët ekonomik dhe grupet e Operatoreve Ekonomike të cilët nuk i plotësojnë as edhe kriteret bazë të kërkuesit sipas FTD-së. Ministria Infrastruktura duke e shpallur fitues për Lot 1 operatorin ekonomik "Kag Asphalt dhe për Lot 3 operatorin ekonomik "Lika Trade" Shpk ne si kompani jemi diskriminuar.

Me rastin e eliminimit nga procedura e tenderimit zyra e prokurimit na ka njoftuar më datën 03.06.2019, duke na e dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar në të cilën thuhet që operatori ekonomik ka ofertuar për III pjesët ndërsa stafin, paisjet dhe procesverbalin e ofertave e ka ofruar vetëm për një pjesë, kjo pikë është e pakjartë dhe e pakuptimtë se si të operatorët ekonomik e rekomanduar për kontratë nuk vlenë kjo pikë ndërsa për kompaninë tonë vlenë, pasi që i referohet për kontratë



DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET OE "Sallahu":

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	22.04.2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike, Punë
Vlera e parashikuar e kontratës për Lot I.....	11,084,163.62€
Vlera e parashikuar e kontratës për Lot III.....	7,008,638.32€
Kriteri për dhënie të kontratës.....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	15.05.2019
Data e hapjes së ofertave.....	15.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	03.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar.....	03.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar.....	03.06.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.....	03.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim e OE "RSM Company".....	05.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim e OE "Sallahu".....	07.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "RSM Company".....	05.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "Sallahu".....	10.06.2019

Kriteret për vlerësim**III.2) KUSHTET PËR PJESEMARRJE****III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**

a) Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092

b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE "RSM Company" dhe "Sallahu", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë", me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Infrastrukturës.

c)Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a)Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit – Aneksi 2.

b)Vërtetim nga Administrata Tatimore.

c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje.

d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës).

b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore).

c) Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit.

b) Kopja e certifikatës së TVSH-së.

c) Kopja e certifikatës së numrit fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjatë 3 viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se pjesën I 10,000,000.00 euro, pjesën II 8,000,000.00 euro dhe Pjesën III 6,000,000.00.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit Vëmendje! Shembull nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 10,000,000.00 euro, për Lot 2 është 8,000,000.00 dhe për Lot 3 është 6,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e qarkullimit të cila duhet të përmbushet nga OE i cili aplikon për tre(3) pjesët (lot) është 24,000,000.00 euro.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

2. Udhëheqës i punishtës Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv,ose infrastrukturë rrugore me së paku 2 vite përvojë punë pas diplomimit si udhëheqës i punishtës në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve; minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

3.Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik - tri vite përvojë punë pas diplomimit, si udhëheqës i punishtës në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë punë pas diplomimit ose gjeodet (shkolla e lartë), ose

Bachelor i diplomuar i gjeodezisë me pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

5. Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune pas diplomimit në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

6. Lista e kontratave të realizuara përfunduar në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 10,000,000.00 euro për pjesën I, 8,000,000.00 euro për pjesën II dhe 6,000,000.00 për pjesën III. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve.

7. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1 për pjesën I, pjesën 2 dhe pjesën 3.

8. OE duhet të jetë i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit.

9. OE duhet të jetë i licencuar për prodhimin e bazës së betonit.

10. OE duhet të jetë i licencuar si gurëthyes zhavorr.

11. OE duhet të ofrojë së bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 CV e inxhinierit, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet të ofrojë një deklaratë që nuk është i angazhuar në porqet të MIT (deklaratë e nënshkruar).

Dëshmia 2 CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 3 CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 4 CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 5 CV, kontrata e punës me punëdhënësin (kopje e noterizuar), diploma (e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Vëmendje! Nëse OE aplikon për pjesën 1, pjesën 2, dhe pjesën 3 në stafin e vetë duhet të prezantojë 3 projekt menaxher, 3 udhëheqës të punës, 3 Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik 3 Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë dhe 3 inxhiniera të komunikacionit.

Dëshmia 6. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare. Vëmendje! Shembull nëse shuma totale e kontratave për punë të kërkuar për Lot 1 është 10,000,000.00 për Lot 2 është 8,000,000.00 dhe për Lot 3 është 6,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e kontratave të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE i cili aplikon për tre pjesë (lot) është 24,000,000.00 euro.

Dëshmia 7. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet të dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vëltur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon për tre pjesë (lot) atëherë duhet të ofrohen pajisje për tre pjesë (lot) sipas listës tek Aneksi 1.

Dëshmia 8 - Kopja e licences së vlefshme të lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.

Dëshmia 9 - Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.
Dëshmia 10- Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje!
Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar.
Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.

Deshmia 11. Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	“Joos Krasniqi”	Junik	8,986,808.46€ lot II	JO
2.	“Arjak”	Gjakovë	9,378,997.91€ lot I	JO
3.	“Pevlaku”	Prishtinë	10,199,769.00€ lot I 9,022,630.05€ lot II	JO
4.	“ABC&Bini”	Podujevë	5,626,137.93€ lot III	JO
5.	“Lika Trade”	Deçan	5,434,111.44€ lot III	JO
6.	“Kag Asphalt”	Prizren	8,590,949.83€ lot I 7,724,209.00€ lot II 5,842,017.10€ lot III	JO
7.	“Ilea GR”	Prishtinë	7,371,371.32€ lot II	JO
8.	“Granit”	Istog	8,761,630.63€ lot II	JO
9.	“Victoria Invest”	Suharekë	8,324,276.08€ lot II 6,071,460.79€ lot III	JO
10.	“Sallahu”	Kaçanik	7,878,002.85€ lot I 7,481,673.30€ lot II 6,427,539.00€ lot III	JO
11.	“Papenburg&Adriani”	Ferizaj	9,888,254.45€ lot I	JO
12.	“Hidro term”	Suharekë	8,289,257.86€ lot II	JO
13.	“El Bau”	Gjilan	5,586,834.21€ lot III	JO
14.	“Company Bejta Commerce”	Gjilan	9,621,965.11€ lot I	JO
15.	“Mirusha Company”	Klinë	6,997,494.05€ lot II 4,885,724.04€ lot III	JO
16.	“Via&Eurokos”	Lipjan	8,653,162.08€ lot I	JO
17.	“Benita Company”	Klinë	7,696,648.60€ lot II	JO
18.	“Burimi&Riviera”	Malishevë	5,390,418.27€ lot III	JO
19.	“Eskavatori”	Ferizaj	9,223,559.21€ lot II	JO

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE “RSM Company” dhe “Sallahu”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës.

20.	“Euro Asphalt”	Gjakovë	5,985,529.41€ lot III	JO
21.	“RSM Company”	Prishtinë	5,289,267.34€ lot III	JO
22.	“Famis CO”	Suharekë	9,682,555.02€ lot I	JO
23.	“Rosi Leopoldo”	Agliana	9,999,112.49€ lot I	JO
24.	“Alko Impex”	Prishtinë	8,670,764.49€ lot II	JO
25.	“Gjikuria”	Tiranë	6,697,222.10€ lot III	JO
26.	“R&Rukolli”	Skenderaj	5,848,326.86€ lot III	JO
27.	“2A Group”	Prishtinë	5,447,477.08€ lot III	JO
28.	“Arfa Group”	Deçan	6,667,939.99€ lot III	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Jetmir Alaj – Kryetar i komisionit
- Zekrie Hadri – Anëtar i komisionit
- Gresa Xhemali – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm për LOT I sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	Kag Asphalt	Prizren	8,590,949.83€
2.	Via&Euro Kos	Lipjan	8,653,162.08€
3.	Famis CO	Suharekë	9,682,555.02€
4.	Papenburg&Adriani	Ferizaj	9,888,254.45€
5.	Rosi Leopoldi	Agliana	9,999,112.49€
6.	PE-VLA-KU	Prishtinë	10,199,769.00€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues “Kag Asphalt” është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 8,590,949.83€. Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE “RSM Company” dhe “Sallahu”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë”, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm për LOT III sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	Lika Trade	Deçan	5,434,111.44€
2.	R&Rukolli	Skenderaj	5,848,326.86€
3.	Arfa Group	Deçan	6,667,939.99€
4.	Gjikuria	Tiranë	6,697,222.10€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues “Lika Trade” është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 5,434,111.44€.

Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE-ve ankues:**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “RSM Company” - Prishtinë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues me këtë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar ofertë vetëm për Lot III, ndërsa pas vlerësimit të ofertave eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Operatori ekonomik ka ofruar procesverbale të pranimit të punëve në vlerë: 5,992,504.67€, ndërsa kërkesë në dosjes të tenderit, për Lot III janë kërkuar projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve në vlerë: 6,000,000.00€.
- Nuk ka ofruar dëshmi për finisher për shtrirjen e asfaltit.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes se pare të eliminimit, lidhur me kontratat dhe referencat, për të cilat AK-MI-ja, ka kërkuar që për Lot III vlera e kontratave dhe referencave në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve të jetë 6,000,000.00€.

OE ankues në ofertën e tij e ka dorëzuar listën e kontratave (gjithsej pesë kontrata) në vlerë totale prej: 7,347,432.75€.

1. Rikonstruimi i rrugës Kukës_Shishtavec Lot 3, vlera: 3,043,477.00€.

Lidhur me kontratën e lartpërmendur, AK-ja gjatë vlerësimit ka vërejtur se në formularin e vlerësimit thuhet se: 60% të punëve i ka përfunduar OE “RSM Company”, ndërsa 40% të punëve OE “Eskavatori” dhe duke u bazuar në përqindjet e dhëna me lart ka rezultuar se OE “Rsm Company”, nga totali i ka realizuar vetëm 1,826,086.20€.

Eksperti shqyrtues, sqaron se me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, OE ankues, për kontratën e lartpërmendur ka dorëzuar dëshmi shtese se i njëjti e ka përfunduar i vetëm projektin në fjalë.

Dëshmitë e prezantuara lidhur me projektin janë: Akt marrëveshja e datës: 10.04.2014, e OE “Rsm Company” dhe OE “Eskavatori”, ku OE “Eskavatori”, tërhiqet nga ky projekt dhe deklaron se përgjegjësia për ekzekutimin e projektit bie mbi OE “Rsm Comapny”.

Poashtu lidhur me këtë kontratë si dëshmi shtese OE “Rsm Comapny” ka ofruar edhe situacionet të cilat i ka dorëzuar tek investitori.

Eksperti shqyrtues, bazuar ne provat e prezantuara me lart, vlerëson se OE ankues këtë kontratë e ka realizuar i vetëm, megjithatë, konform nenit 72 te LPP-se, AK-ja, është dashur te kërkoj sqarime shtese pran autoritetit kontraktues – investitorit i cili e ka nënshkruar këtë kontratë me OE “Rsm Company” për te sqaruar ne mënyrë te detajuar këtë kontratë sepse siç është sqaruar edhe me lart ne raportin e vlerësimit thuhet se: 60% te punëve i ka realizuar OE “Rsm Company” ndërsa 40% te punëve janë kryer nga OE “Eskavatori”, ndërsa ne situacionet e dorëzuar te po i njëjti investitor rezulton se punët janë kryer vetëm nga OE “Rsm Company”, duke u bazuar këtu edhe ne akt marrëveshjen ku OE “Eskavatori” është tërhequr nga ekzekutimi i projektit.

2. Rikonstruimi i bulevardit Fan Noli dhe ndriçimi i unazës Korc, me vlerë: 1,330,405.80€

Lidhur me këtë kontratë AK-ja, pretendon se kontratat janë kërkuar ne lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve.

Eksperti shqyrtues, poashtu vlerëson se edhe kjo kontratë duhet te sqarohet me detajisht, për vet faktin se titulli: Rikonstruimi i Bulevardit, nuk do te thotë se nuk ka asfalt, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, nuk ka nxjerr një konstatim te saktë lidhur me këtë kontratë.

Ne fund, sa i përket kontratave dhe referencave, eksperti shqyrtues, vlerëson se pa verifikimin dy kontratave te lartpërmendura është e pamundur te konstatohet se a e plotëson kërkesën e AK-se ne vlerë prej: 6,000,000.00€, për faktin se këto dy kontrata e bëjnë dallimin se a e plotëson OE ankues “Rsm Company”, kërkesën për kontrata dhe referenca.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit, lidhur me finisherin, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues konform kërkesës se dosjes se tenderit ka ofruar dëshmi se e ka ne posedim Finsherin. Pra, për te njëjtën pajisje OE ankues ka dorëzuar marrëveshjen me OE “Rruga Ing” dhe faturën si dëshmi se e ka ne posedim, qe do te thotë se kjo arsy e eliminimit te OE ankues nuk qëndron.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne letrën standarde te tenderuesit te eliminuar është edhe një pik tjetër, ku thuhet se: Inxhinieri i Gjeodezisë i prezantuar nga OE “Rsm Company”, është ne moshën 73 vjeçar. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues nuk mund te jap ndonjë sqarim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Sallahu” - Kaçanik.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues me këtë aktivitet te prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot I, II dhe III, ndërsa pas vlerësimit te ofertave eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Operatori ekonomik menaxherin e projektit, udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierin e komunikacionit e ka ofruar me kontratë Sallahu Shpk, ndërsa noterizimin e kontratës është Sa – Sallahu me nr. Unik 811233668 (biznes tjetër).
- Inxhinieri i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik dhe inxhinieri i gjeodezisë ka ofruar kontratë me Sallahu Shpk, ndërsa noterizimi me NNT Sallahu e cila ne ARBK figuron si kompani e mbyllur nga 2018 (Jo aktive).
- Operatori ekonomik ka ofertuar për III pjese ndërsa stafin, pajisjet dhe procesverbalin e ofertave e ka ofruar vetëm për një pjese.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e parë te eliminimit sqaron se ne oferte ne tij OE ankues, ka dorëzuar kontratën e lidhur me mes te OE “Sallahu” Shpk nr. i biznesit 810135237 dhe inxhinierit përkatës, ndërsa

kontrata është noterizuar në emër të një biznesi tjetër – SA Sallahu nr. i biznesit 811233668.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimin e dhënë nga AK-ja, në letrën standarde ka bërë verifikim në ueb faqen e ARB-se, në të cilën figuron që Sallahu Shpk dhe SA Sallahu janë subjekte të ndryshme përkatësisht me numra të ndryshëm të biznesit.

Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se ka qenë një gabim teknik për faktin se OE “SA Sallahu” ekziston i regjistruar në ARBK.

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se në ofertë ekziston vërtetimi i lëshuar nga ARBK-ja me datë: 20.07.2018, në të cilin thuhet OE Sallahu N.N.T e ka ndryshuar tipin si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “Sallahu” Shpk.

Prandaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se me të drejtë e ka eliminuar AK-ja, për faktin se në vërtetimin e bashkangjitur nga vet OE ankues “Sallahu” thuhet se nga 20.07.2018 nuk ekziston N.N.T Sallahu por Sallahu Shpk, ndërsa vula noteriale mban shifrën LRP.nr.1962/2019. Që do të thotë se noterizimi është bërë për N.N.T Sallahu i cili në kohën kur është bërë nuk ekziston me këtë tip, por si Shpk.

Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, në dosje të tenderit ka kërkuar stafin profesional dhe njëherit në lidhje me stafin ka dhënë sqarimin si më poshtë:

Vëmendje! Nëse OE aplikon për pjesën 1, pjesën 2 dhe pjesën 3 në stafin e vetë duhet të prezantojë 3 projekt menaxher, 3 udhëheqës të punishtes, 3 Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik, 3 Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë dhe 3 inxhiniera të komunikacionit.

Në rastin konkret OE ankues në ofertën e tij i ka dorëzuar dëshmit për stafin vetëm për një Lot, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit ka ofertuar në tri Lote.

Në fund sa i përket ofertës së OE ankues “Sallahu”, eksperti shqyrtues vlerëson se me të drejtë AK-ja, e ka eliminuar për faktin se siç u sqarua edhe më lart, OE ankues ka dorëzuar dëshmi – kontrata pune të lidhura në mes të punëmarrësit dhe OE “Sallahu” Shpk, ndërsa janë noterizuar për një operator ekonomik tjetër i cili në bazë të numrit të biznesit është subjekt tjetër dhe i njëjti nuk është në konzorcium me OE “Sallahu” dhe nuk është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues në lidhje me ofertën e të rekomanduarit për kontratë për Lot I OE “Kag Asphalt”, për të cilin pretendon se i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me kontratat për Lot I, ku AK-ja, ka kërkuar që vlera të jetë 10,000,000.00€.

Eksperti shqyrtues, pas ka ekzaminuar listën e kontratave të dorëzuar në ofertën e të rekomanduarit për kontratë, fillimisht sqaron se OE i rekomanduar për kontratë për Lot I ka dorëzuar liste në kontratave në vlerë afër: 12,000,000.00€.

Duke u bazuar në vlerën e lartpërmendur, OE ankues “Sallahu”, pretendon se për kontratën e dorëzuar nga i rekomanduari në vlerë prej: 2,809,341.46€, nuk ka dorëzuar pranim përfundimtarë të punëve por, vetëm reference, eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron ky pretendim për faktin se i rekomanduari për Lot I nuk ka dorëzuar pranim përfundimtarë sipas kërkesës së dosjes së tenderit por vetëm reference. Lidhur me këtë kontratë eksperti shqyrtues, sqaron se kjo kontratë është lidhur me komisionin evropian. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo është dashur të verifikohet lidhur me pranimin përfundimtar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, për kontratën me titull: ndërtimi i rrugës Retij – Mamush, se në raportin përfundimtarë nuk ka vlerë projekti në fjalë, eksperti shqyrtues sqaron se për kontratën e

lartpërmendur përveç raportit përfundimtarë të dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar edhe referencën në të cilën jepet projektin, prandaj është i paqëndrueshëm ky pretendim.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, në lidhje me kontratën e lidhur me AK-MI, për projektin: Zgjerimi i rrugës nacionale M9 segmenti D Lot II (Lozic-Mleqan), eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim qëndron për faktin se kjo kontratë është vitit 2013, dhe për të njëjtën AK-ja, gjatë vlerësimit është dashur të merr vetëm pjesën e realizuar brenda viteve të kërkuara në dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Pretendimi i OE ankues në lidhje me pajisjet të cilat janë me afat të skaduar të regjistrimit, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk mund të eliminohet një OE për afat të regjistrimit të automjeteve.

Sa i përket pretendimit të OE ankues në lidhje me pajisjen nr. rendor 6, ku AK-ja, ka kërkuar Autopomp betoni, ndërsa i rekomanduari për kontratë ka ofruar Autobetonier dhe në librezë nuk ka me shumë të dhëna. Prandaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se në mungesë të dhënave AK-ja, është dashur të kërkojë sqarime me të detajuara.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Sallahu" ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë për Lot III, OE "Lika Trade", për të cilin pretendon se nuk ka kontratë dhe referencë sipas kërkesës së AK-së, për Lot III. Eksperti shqyrtues, sqaron se për Lot III, AK-ja, ka kërkuar kontratë dhe referencë për periudhën e shkuar në vlerë prej: 6,000,000.00€, dhe pas ekzaminimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë ky operator ekonomik e plotëson kërkesën e AK-së për Lot III.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, për pajisjen e kërkuar në pikën 2 të listës së pajisjeve, ku OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar me arsyetimin se ka ofruar kamionin me targa 03-341-BI, ndërsa kërkesë ka qenë për kamion kiper 10m³. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, për pajisjen në fjalë ka kërkuar sqarim nga i rekomanduari për kontratë i cili ka ofruar dëshmi shtesë lidhur me pajisjen, prandaj është i paqëndrueshëm ky pretendim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues RSM Company për Lot III të aprovohet si e bazuar dhe të anulohet njoftimi për vendim për dhënie të kontratës për Lot III, ndërsa ankesa e OE ankues "Sallahu" të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të anulohet vendimi për dhënie të kontratës për Lot I dhe lënda të kthehet në rivlerësim.